



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2018

V E N D I M

Nr. _____, Datë ___/___/2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 2, datë 03.01.2018, e Z. S.H., ku pretendohet për diskriminim “për çdo shkak tjetër”, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit të dërguar nga ankuesi, rezulton se Z. S.H. ka qenë punonjës pranë Doganës Kakavijë. Me vendimin e ndërmjetëm nr. 8559/5, datë 11.04.2017, të Komisionit Disiplinor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ankuesi është pezulluar nga detyra. Ky vendim është marrë si pasojë e fillimit të procedimit penal nr. 216, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, ndaj ndaj shtetasve B.P. dhe K.Gj, të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 174, 175 dhe 186 të Kodit Penal. Parakushti për zgjidhjen e kësaj çështjeje, për të cilën ka qenë kompetente Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, është përmbushur me lëshimin e vërtetimit të datës 30.05.2017, nga ana e këtij institucioni, nëpërmjet së cilit